


GRUSHTI DHE NJESHI

JANI JORO

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-52-93

776



roman

814-31-93

KFB

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

JANI JORË

GRUSHTI DHE NJËSHI

(roman)



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

*Sa peshon një padrejtësi e
madhe në botën e të vegjë-
ve?...*

A U T O R I

AJORA, MBËRRIN NË MESNATE

Drita e mëngjezit i zbuloi ngadalë sendet e dhomës ku flinte. Në një pikturë përballë saj dukej një pamje e çuditshme: përrenj të thellë të rrethuar me pyje të frikshme. Mbi një kodër, nën hijen e halave të pishave, dy burra kishin një mitraloz dhe ca arma me fishekë. Njërit po i binte qylafi nga koka, me gjithë zhgabën e stamposur në të, tjetri shtrëngonte një revolver. Të lebetitur, seç bisedonin me vdekjen, ndërsa sytë u lëshonin rrathë të kaltër. Tyta e revolverit drejtohej mbi një djalë fare të ri, pothuaj fëmijë. Ky djalë mbante në dorë një bombë dhe i shkrepëtinin sytë. Djalit era ia ngrinte pallton e shkurtër, flokët dhe ngjiste si flamur atje në kodër. Prapa gjelbëronin degët e errëta të trungjeve halore. Edhe më prapa vinte qielli me miliarda dritareza.

Syri i saj gati i fjetur kaloi pastaj mbi sendet e tjera. Mbi tryezë rrinte një vazo me lule të freskëta. Kush i kishte vënë, vallë, gjatë natës? Më tej një raft me libra, mu në qoshe, atje ku perdet e trasha varen mbi kornizën e hollë të dritares.

E ndjeu, më në fund, veten në krevatin e saj. Ku ndodhej? Agimi kishte hyrë fshehtazi nga dritaret,

ndërsa përkundej e kotej në një ndjenjë shqetësimi të lehtë, të ëmbël... Po i dukej si një ëndërr tek dëgjonte, ashtu pranë, ca çuçuritje e pëshpërime të panjohura, të buta, edhe të largëta. Kjo ia trazonte shpirtin e ia dëbonte gjumin. Ishin zërat e panjohur të sendeve të reja, po ndoshta qe dhe fërfëllima e shuar e asaj pjeshkës që dukej nga xhami, ngarkuar me kokrra të arrira, tërë push të verdhë. Siç duket, ajo e lëshonte atë dialog të çuditshëm...

Lëvizi në shtrat një herë vetëm. Se si i hapi sytë. Befas zërat e çuditshëm pushuan dhe e mbështolli mëngjezi i kristaltë. U bind se në dhomë qenkëshin ajo, piktura, lulet dhe drita. Fërkoj sytë, pa rreth e rrotull e u kujtua më në fund ku ndodhej. Buzëqeshi, u shtri dhe ra mbi jastëk.

Kjo qe shtëpia ku do të banonte tani e tutje, bile jo vetëm shtëpia, por edhe qyteti. Si komandant që është, babai i saj shërben kudo që e dërgon partia. Kishte disa javë që jetonte këtu, në vendlindje, vetëm, larg tyre... Kurse ato, ja, erdhën më në fund. Asaj s'i durohej. Befas iu kujtua ndarja nga shokët dhe shoqet e klasës dhe, siç rrinte shtrirë, e mbyti malli për të gjithë ata që kishte lenë. E ndjeu me të vërtetë ndarjen prej miqve të saj.

I solli ndër mend. S'dinin ç't'i thoshin më parë, ndërsa plackat e tyre ngarkoheshin me radhë në maqinë. Pikëllimi ua pengonte fjalët të dilnin e u rrinin si një kokërr arre në fyt. Lot s'u dilnin, se u vinte turp. Vetëm Verkës s'i bëhej vonë dhe i rridhnin lumë.

Tani i tingëlloi si jehonë zëri i njërit:

— Ajorë, do të na kujtosh?...

— Patjetër, Bujar. Kurrë s'kam për t'ju harruar.

— Po letra? — e pyeti Verka.

— Edhe letra. Me të vajtur.

— Do të hyjmë në rini pa ty, rri gjer pasnesër kur të mblidhemi!... — Kjo që i tha Verka s'mund të bëhej.

— Po s'ka gjë, — i thanë shokët, — atje ku do të vejë Ajora, do të pranohet menjëherë.

— Këtu është ndryshe, — ngulte këmbë Verka.

— S'ka gjë, Verkë, ne kemi besim të gjithë tek Ajora.

Bujari i ngriti shoferit dy karrige, që i vuri mbi karroceri, pranë një pasqyre të madhe. Kishte ardhur ta përcillte dhe ai Artani, që e kritikoi në mbledhjen e fundit, se kishte vërshëlyer në mes të filmit në kinema. Artanit iu skuqën veshët atëhere. Kujtoi se do të mbante mëri, po ja që erdhi. Një pikëllim i gëzuar ia shpoi zemrën. Kush e dinte se do të ndahe-shin përgjithnjë?

I thoshin:

— Ke gjyshen, ta dish!...

— Na ka dhe ne, — u thoshte gjithnjë Verka. — Do të vijnë pushimet dhe ja, ne përsëri së bashku do të jemi...

Ajora besonte në miqësinë e tyre të madhe, por ajo s'e dinte... Babai po i shkonte larg, shumë larg, në vëndlindjen e tij. Atje ku kishte kaluar rininë e parë, atje ku ndodhet një lapidar, i vëllai, rënë për liri, domethënë xhaxhai i saj.

U gëlltit:

— Do të vij, do të vij patjetër...

Po premtimin nuk e mbajti. Vorbulla e jetës që e priste në këtë qytet, bëri të mos i kalojë pushimet mes miqve të saj të shtrenjtë.

... Ndërkohë gjithshka përfundoi. Shoferi ushtarak i njoftoi babait dhe e ftoi të hipte e para. Atë-

here Verkës iu këputën nëpër faqe kokrra të tjera të ndritshme. I fshiu fët e fët me kurrizin e dorës. Sa e mirë që ishte! Ç'e donte mamaja e Ajorës! Qenë si dy motra. E puthi fort.

Kur u dha te dera babai, me pelerinën e shiut në dorë, i përqafoi të gjithë. Ai hyri në mes:

— Uroj të jeni gjithnjë miq dhe të mësoni!
Faleminderit, të gjithëve!

Shokët e shoqet ia vështruan babanë me respekt.
Ra boria.

— Mirëmbetshi, miq!

— Udhë të mbarë!

— Mirëmbetshi, mirupafshim!

Duart e tyre valaviteshin. Maqina u ndez. Verka e përlotur seç' i thoshte.

Ca nga ca, shokët e fëmijërisë bashkë me bulevardet e gjëra mbetën prapa. Një fjollë tymi u ngjiti me shpejtësi drejt qiellit dhe u tret hapësirave të kaltra.

Qytetthi i priti me drita të rralla. Tek-tuk errësohej papritmas ndonjë dritare e mbetur dhe gjumi endej nëpër shtëpitë. I rëndonin qepallat, po i hapte me zor që t'i bindte ata se nuk ishte ndonjë çupkë gju-mashe si ato që shohim duke fjetur nëpër autobuzë mbi prehërin e nënave të tyre. Papritur iu këput koka mbi supin e të atit. Ai i hodhi krahun.

— Epo, Ora, mbahu! — i tha me një qortim të shtirur. — Të flemë më mirë në shtëpi sonte.

— Si? Çfarë?... Ku jemi!

Vajza sa s'u hodh përpjetë. Frenuan përpara një porte.

— Në shtëpinë e ëndërrës, bija e ime.

— Ua, po unë... unë s'kam fjetur hiç! — bërtiti nga kjo padrejtësi e hapur.

Ata qeshën. Në dritën e zbetë të kabinës u skuq. Babai iu mbajt rëndë-rëndë. Dhe ajo kërkoi ndihmë nga shoferi ushtarak, po ai ngrinte vetëm supet e qeshte papushim, sikur t'i thoshte: «Vajzë e mirë, s'kam ç'të të bëj... Fjete».

— M,mëë, — i picërroi sytë babai, — po atëhere, bijo, në ç'pikë të rruzullit jemi?

Si gjithnjë, kur ngulte këmbë në të sajën, kërkonte ta bindje për atë që i thoshin. Tallej tani apo s'tallej babai i saj i shtrenjtë. Vështroi nga xhami i kabinës një portë me kangjella. Thirri papritur:

— Përpara portës së babushit tim.

Kabina për pak u nda më dësh nga të qeshurat e tyre. S'kishin ç'të thoshin. Qëlloi në shenjë. Dhe për këtë, mbahej tri herë më rëndë se ata. Iu hodh pastaj në prehër, kurse ai ia lëmoi kaçurrelat e saj të egra.

Befas u ndezën të gjitha dritat dhe doli nëna. Kishte ardhur disa ditë më parë të shihte.

Kur mbaroi gjithshka, ishte vonë...

Mbrëmë s'pati kohë ta sodiste dhomën e saj, por ja, tani, porsa u zgjua, iu duk e çuditshme çdo gjë: dhoma, piktura, lulet, bile dhe drita e këtij mëngjezi malor.

MËNDJEKËNDEZI

Kështu gjumit të saj ia zuri vendin një kureshtje e madhe për të parë nga dritarja. Meqë s'pipätinte frymë e gjallë, pandehu se kushedi se sa heret ishte zgjuar.

«Flenë të gjithë», — mendoi e gabuar, sepse në atë çast një piskamë e mprehtë e theri ajrin kaq papritur, saqë i kaluan të ngjethura. Mbajti frymën dhe u mbështet mbi një brryll.

— Ii, ii...i — vazhdonte piskama.

— Ç'po bëhet! — tha.

— ...

— Hë... qerrata, të zura!


Të ngjethurat i shkuan, po ky zë i kënaqur njeriu i nderi kureshtjen për të parë.

«Kush bërtiti?... Po ky, ç'zuri kështu!?...»

Nga një goditje me këmbë, jorgani iu ngrit në ajër dhe ra në fund të shtratit. Me t'u derdhur në dritare, ç'të shihte? Në oborin e fqinjës, këmbëkryq, një djalë ndonjë vit a dy më i madh se ajo, u jepte jonxhë dy lepurushëve të bardhë si bora. E mahnitur vuri gishtin në buzë:

— Ah, sa të bulkur!

— ...



— Sa të buukur! — thirri këtë radhë ta dëgjonte ai. Djali nuk dha asnjë shenjë.

— Uf, sa gjynah, qenka shurdh!... — i tha vetes prapë me zë të lartë, por më kot. Ai vetëm u kollit një herë, por kësaj shenje vajza s'i dha asnjë rëndësi. Ata borëbardhët përtypeshin.

Përkundraill dolën rrezet e diellit nga mali dhe e verbuan. Poshtë, në hije, ai fqinji i ushqente lepu-rushët pa çarë kokën për të.

Një nga lepujt vajti te lulet, në fund të oborrit; papritur, djali u derdh pas tij.

Nga trupi dukej i lidhur mirë. Qe flokëzi. Vetëm një cep i jakës i rrinte si veshlepuri. Nga kjo mendoi se do të kishte fjetur me të.

Ra dielli dhe nëpër oborre. Lepurushi veshllapushi kërceu dy hapa më tej dhe ai mënt ra. Në këto pamje komike të qeshet shumë. Prandaj zëri i saj u shpërnda pa drojtje, si cicërrimë:

— Hi, hi... iii,i!...

— ...

Befas djali u kthye. Çfarë sysh të bukur paska! Bojë qielli. Me ca vetulla hark. Nuk iu duk vështrim miqësor, por s'e quajti të udhës të pushonte. Prapë s'i foli, por ktheu shpatullat dhe u ul galuc, me një mospërfillje të dukshme. Lepuri rrinte strukur në fole. Por, me ta futur hundën djali poshtë dërrasave, kafshëza e trembur rrëshqiti përsëri në oborr. Kur e kuptoi se e kërkonte më kot, u nxeh; me një kërcim të rrufeshëm iu gjend pranë dhe e mbërtheu për veshësh. Lepurushi i gJORë, që pak më parë i ngrinte e i ulte veshët tërë gëzim, tani s'pipëtinte. Por djali s'u kënaq. Kishte një hesap tjetër për të larë. Dhe e kishte me vazhën.

— Po ti atje, — iu shkreh ai, — ç'më hingëllin si mëzkë? Apò të hanë turinj të!...

— ...

Ku ishte përgatitur për një përshëndetje të tillë! Iu err dheu. Ato fjalë i ranë si shpulla. Kush, ajo mëzkë!? Ajo!... Dhe kujtoi se qe shurdh, pa le. U mek fare nga këto sharje dhe padashur belbëzoi:

— Mirëmëngjez!

— Si? U, u...u... Ç'tuafe!... Unë e shaj, ajo më thënka faleminderit! U...u...u!

Papritur i bëri një lëshim:

— Po ç'do ti atje? Hë, ç'kërkon në atë dritare?

— ...

I kishte ikur goja. Ai nuk ia përtoi ta përqueshte dhe lëvizi krahun sikur t'i vriteshin sytë. Dukej she-